



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilbjen / Prodato Received / Delivery	28.08.2023	3	viti god Year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTRA	5828/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.896/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.896/2023 të datës 30.06.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë f.sh. Krojmir Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Komunës së Lipjanit, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.896/2023 e datës 30.06.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Mbetet në Fuqi Njoftimi me numër protokollit 01-111/01-27281 i datës 29.05.2023 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] anandidate për shërbim civil, më datë 30.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4977/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe përgjigjes jo të plotë të ankesës nga Komisioni i Ankesave dhe Parashtresave.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores

Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit, ndërsa Këshilli më datë 13.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga e njëjta me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4977/2023 të datës 30.06.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi për pranim në Komunën e Lipjanit për pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale 2" me numër reference: RN00011227 i datës 16.03.2023; Ankesën e ankueses S.Q. me numër protokolli 01-111/01-27698 të datës 31.05.2023; Përgjigje në ankesë nga Menaxherja e Personelit në Komunën e Lipjanit me numër reference: 01-111/01-27698 të datës 01.06.2023; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 14.04.2023; Diplomën të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me Nr.1252 të datës 30.10.2008 për S.Q.; Certifikatë për S.Q nga MPMS e datës 12.05.2010; Certifikate për S.Q nga Unicef të datës 24.09.2013; Kontratën për pune praktike nga komuna e Lipjanit për S.Q. me numër protokolli 01-112/08-28187 të datës 01.06.2022; Referencë nga komuna e Lipjanit për S.Q. me Nr. 786-113 të datës 30.11.2022; Rekomandim nga QMGF për S.Q. të datës 20.03.2012; Vërtetim nga QKMF në Lipjan për S.Q. me Nr.9/2 të datës 11.02.2010; Letër referencë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për S.Q. me Nr.04-052-39 të datës 10.02.2021; Aplikacioni i kandidates S.Q. ; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 07.07.2023; E-mail nga C.Z. për Xh.Z. i datës 07.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 13.07.2023; E-mail nga B.B. për C.Z. i datës 10.07.2023; Lista e aplikateve në konkursin me numër reference: RN00011227; Vendimin për formimin e komisionit për pranimin në shërbimin civil nga komuna e Lipjanit me Nr.1-020/04-23850 të datës 10.05.2023; Ankesën nga S.Q. për komisionin e ankesave dhe parashtrësive me Nr.01-111/01-27698 të datës 30.05.2023; Diplomë nga shkolla e mesme e mjekësisë " Dr. Ali Sokoli" Prishtine për S.Q. me numër protokolli 1992 të datës 12.06.1994; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për S.Q. me numër 04-052-3167 të datës 09.09.2019; Certifikate mbi dënimet penale e S.Q. e datës 10.02.2023; Njoftimin e komisionit për pranim të kandidatit/se të suksesshëm me numër reference: RN00011227 të datës 29.05.2023; E-maili i datës 12.07.2023 nga Xh.Z per C.Z; Aplikacioni i kandidates H.Q. i datës 07.04.2023; Diplomë për kryerjen e shkolles së mesme të lartë Gjimnazit e H.Q. me numër protokolli 300/204 të datës 01.07.2015; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për H.Q. me numër Nr.6795 të datës 07.10.2019; Certifikatë për H.Q nga IJR Studentet e Prishtinës; Certifikatë e lëshuar nga EBF për H.Q. e datës 03.12.2018; Certifikatë e lëshuar nga FOM për H.Q; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për H.Q. e muajt Tetor 2021; Certifikatë nga UNDP per H.Q; Certifikatën nga UNDP për H.Q.; Certifikatën nga MASHTI për H.Q; Vërtetim nga qendra për "Autizmi" për H.Q. i datës 24.05.2018; Vërtetim mbi praktiken të lëshuar nga SHHBK për H.Q. me Nr.38 të datës 10.06.2019; Vërtetim nga komuna e Lipjanit për H.Q. me Nr.3-113-8032 të datës 15.03.2022; Pasqyra e trustit pensional e datës 12.06.2022 për H.Q; Kontratë e vullnetarit të OKB-së të datës 27.04.2021; Vërtetim nga "Instituti i Shërbimeve Psikologjike-kutia" për H.Q. i datës 01.11.2022; Referencë nga DSHPS komuna e Lipjanit për H.Q i datës 26.09.2022; Letërnjoftimi i H.Q.; Certifikatë mbi dënimet penale për H.Q. i datës 06.04.2023; E-mail nga B.B për C.Z i datës 19.07.2023; Akt Emërim me Nr.1-031-8565 i datës 20.07.2012 për R. H; Akt Emërim me numër

AE.Nr.1-112-37766/2021 i datës 09.07.2021 për A.M; Akt Emërim me numër AE.Nr.01-112-01-462/2023 i datës 20.01.2023 për Xh.M; Akt Emërimi me Nr.1-031-11257 i datës 01.11.2012 për Z.S; Kontratë pune nga komuna e Lipjanit për A.Sh. pa numër pa date.; E-mail nga Xh.Z. për C.Z. i datës 10.08.2023; E-mail nga C.Z. për Xh.Z. i datës 10.08.2023; E-mail nga Xh.Z. për C.Z. i datës 10.08.2023; Formulari për vlerësimin e CV të S.Q. i datës 23.05.2023; E-mail nga Xh.Z. për C.Z. i datës 10.08.2023; E-mail nga Xh.Z. për C.Z. i datës 10.08.2023; E-mail nga Xh.Z. për C.Z. i datës 10.08.2023; Akt Emërim i Xh.I. i datës 01.01.2012; Kontratë e Marrëdhënies së punës e Xh.I. i datës 01.01.2011; Kontratë e Marrëdhënies së punës e Xh.I. i datës 01.01.2010;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses, është e pabazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar ankesë me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe përgjigjes jo të plotë të ankesës nga Komisioni i Ankesave dhe Parashtrësve e njëjta pretendon se i është mohuar e drejta në vlerësim të barabartë dhe se pikët në CV nuk janë vlerësuar mjaftueshëm, po ashtu pretendon se përbërja e Komisionit për Pranim ka qenë në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, sipas shkresave të lëndës, ka konstatuar se Komuna e Lipjanit, sipas njoftimit të datës 16.03.2023 ka publikuar konkursin për pranim me emrin e grupit Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale 2", me numër reference RN00011227 për afatin për aplikim nga data 06.04.2023 deri me datë 20.04.2023, e ka shpallur duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Sipas konkursit me numër reference RN00011277, dhe njoftimit të datës 16.03.2023 i shpallur për aplikim nga data 06.04.2023 me emrin e grupit Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale 2" në Komunën e Lipjanit, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, Fakulteti i Psikologjisë, Punë Sociale, Sociologjisë dhe Juridik.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër referencës RN00011227 nga Komuna e Lipjanit, i publikuar sipas njoftimit të datës 16.03.2023 dhe afati për aplikim nga data 06.04.2023 deri me datë 20.04.2023, në vendin e lirë të punës Specialist të

Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale 2" në Komunën e Lipjanit.

Nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore që ndërlidhen me këtë pozitë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja në bazë të provave të lëndës është përfshirë në listën e verifikimit paraprak, ndërsa është ftuar të marr pjesë në testimin me shkrim ku pas kësaj faze ka marr gjithsej 44 pikë në testin me shkrim, ndërsa pas kësaj faze është bërë vlerësimi i jetëshkrimit ku rezulton se sipas formularit të vlerësimit të jetëshkrimit ankuesja është vlerësuar me dhjetë (10) pikë. Rrjedhimisht në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit CV-së të datës 23.05.2023 nga komisioni rekrutues ankuesja është vlerësuar për nivelin e arsimimit me shtatë pikë (7), përvojën e punës me dy (2) pikë dhe trajnimet që lidhen me vendin e punës një (1) pikë, gjithsejtë 10 pikë, ndërsa në total gjithsejtë 54 pikë. Andaj e njëjta pas vlerësimit të biografisë nuk i ka plotësuar kriteret për tu ftuar në intervistë me gojë.

Ndërsa me datë 29.05.2023 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit ka nxjerr njoftimin me numër protokollit 1-111/01-27281 ku ka përzgjedhur kandidatin e suksesshëm H.Q. me gjithsej 80.2 pikë.

Ankuesja me datë 31.05.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin e ankesave dhe parashtrësave në komunën e Lipjanit kundër njoftimit me numër protokollit 1-111/01-27281 të datës 29.05.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore. Njësia e Burimeve Njerëzore ka nxjerrë përgjigje në ankesë me datë 01.06.2023 me të cilën e ka njoftuar ankuesen se në vlerësimin nëpërmjet testimit me shkrim keni marrë 44 pikë, si dhe vlerësimi i jetëshkrimit/CV-ja 10 pikë dhe gjithsejtë keni 54 pikë, mbi këtë bazë nuk i keni plotësuar kriteret për tu ftuar në intervistë me gojë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se bazuar në përgjigjen e personelit në Komunën e Lipjanit të datës 01.06.2023 si dhe shkresat e lëndës ankuesja ka arritur gjithsejtë 54 pikë kështu që sipas provave të lëndës, ankuesja nuk ka arritur të grumbulloj pikët e nevojshme për t' u nënshtruar në intervistën me gojë, ngase sipas nenit 34 paragrafi 10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: **"10. Kandidatët të cilët nuk i fitojnë 60% të pikëve nuk ftohen në intervistën me gojë"** dhe nenit 23 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **"1.Pas vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën me gojë. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë"**. Bazuar në dispozita ligjore në fuqi konkretisht sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 34 paragrafi 1, 2, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të këtij ligji, dhe deponitave të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht nenit 14, 15, 16, 21, 22, 23 dhe 25, kështu që procedura e pranimit për grupin Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale 2" në Komunën e Lipjanit është bërë në pajtim me nenin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për

Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimet e ankueses ndaj kësaj procedura janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se Komisioni i Pranimit ka bërë vlerësimin e ankueses dhe kandidatëve të tjerë sipas procedurave sepse vlerësimi i kandidatëve përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit /CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë, siç parashihet me nenin 16 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa nga të gjitha vlerësimet e ndërlidhura me nenin 21, 22, 23 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me nenin 24 të kësaj rregulloreje, përcaktohet se: *"Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit"*. Bazuar në këtë publikimi i renditjes përfundimtare të kandidatëve është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *"2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues"*, mirëpo meqë në këtë konkurs është kërkuar vetëm një vend pune, atëherë kandidatja e rënditur me më së shumti pikë që në bazë të Njoftimit të datës 29.05.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Lipjanit është Hyrije Qerkini që ka marr gjithsejtë tetëdhjetë pikë dy pikë 80.2 pikë, emërohet në këtë pozitë sipas nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Kandidati fitues, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, njoftohet nga njësia përgjegjëse për pozitën e lira dhe ka të drejtën të përzgjedhë çdo pozitë të lirë të Grupit dhe të emërohet në të, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të të njëjtit Grup, që krijohet e lirë deri në një (1) vit nga shpallja publike e listës të kandidatëve fitues"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se vendimi për formimin e Komisionit për pranim në shërbimin civil për pozitën Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën *"Zyrtar për Shërbime Sociale 2"* me RN00011227 me numër Nr.1-020/04-23850 i datës 10.05.2023 ka qenë në pajtim me nenin 68 paragrafin 7 ku përcaktohet se: 7. Komisioni i përzgjedhjes është ad hoc, themelohet nga organi emërtues dhe përbëhet nga të paktën 5 persona, ku të paktën tre (3) prej tyre janë profesionistë të fushës në të cilën bëhet vlerësimi i kandidatëve, një (1) është profesionist në fushën e përzgjedhjes të burimeve njerëzore dhe një (1) tjetër është përfaqësues i NJBNJ. Komisioni i përzgjedhjes themelohet për çdo grup apo pozitë për të cilën zhvillohet konkurrimi.

Në bazë të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankueses, konstaton se procedura për grupin Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën *"Zyrtar për Shërbime Sociale 2"* në Komunën e Lipjanit, me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri tek përzgjedhja përfundimtare e kandidates ka vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, 2 ligji nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se; 1. *Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe*

proporcional gjinor dhe të komuniteteve.2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive, si dhe në pajtim me nenin 4, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë.

Bazuar në konstatimet si me lart, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.896/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

